

OBSERVATORI PËR TË DREJTAT E FËMIJËVE DHE TË RINJVE

Newsletter nr.14, Korrik 2018

“SHKOLLAT SI KUNDËRSHTARË TË VIJËS SË PARË TË EKSTREMIZMIT TË DHUNSHËM”

Qëllimi

Parandalimi dhe luftimi i ekstremizmit të dhunshëm duke angazhuar shkollat si një institucion kryesor i vijës së frontit.

Objektivat

- Rritja e kapaciteteve të shkollave për t'u angazhuar në përbalimin e ekstremizmit të dhunshëm
- Formimi i konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm për 600 nxënës të shkollës dhe pjesëtarë të komunitetit.

Zonat e shtrirjes: Kamëz, Elbasan dhe Pogradec

Observatori për të Drejtat e Fëmijëve dhe të Rinjve (Observatori) në kuadër të skemës së granteve të vogla të projektit “ *Fuqizimi i Shoqërisë Civile në Rritjen e Reziliencës së të Rinjve ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm*” i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga Terre des Hommes Shqipëri në partneritet me ISD , CCG dhe Universitetin Bedër, po zbaton projektin “*Shkollat si kundërshtarë të vijës së parë të ekstremizmit të dhunshëm*”

Çfarë është realizuar deri tani

- Në funksion të ngritjes së kapaciteteve të shkollave për t'u angazhuar në luftimin e ekstremizmit të dhunshëm janë trajnuar 67 mësues dhe pjestarë të stafit të tre shkollave pilot ku është shtrirë projekti dhe përkatësisht:
 - Shkolla e mesme “Mahmud & Ali Cungu” Elbasan
 - Shkolla e mesme “Ibrahim Rugova” Kamëz
 - Shkolla e mesme e bashkuar “Dëshmorët e Pojskës” Pogradec



- Në bashkëpunim me ekspertë të MASR dhe IZHA-s është hartuar drafti i udhëzuesit për mësuesin kujdestar të shkollës së mesme “Në ndihmë të zhvillimit të orëve të kujdestarisë për trajtimin e temave mbi ekstremizmin e dhunshëm”. Udhëzuesi përmban përveç të tjerash edhe 5 tema për trajtimin e fenomenit të ekstremizmit të dhunshëm të cilat synohen të bëhen pjesë e programeve mësimore të shkollave të mesme në vitet e ardhshme shkollore.
- Në funksion të formimit të konceptit kundër ekstremizmit të dhunshëm për nxënësit, mësuesit e shkollave, prindërve dhe pjestarët e komunitetit janë realizuar 6 debate publike me lektorë të ftuar nga institucionet locale si; policia, institucionet arsimore, fetare, OJQ-të, qytetarë të njohur dhe ekspertë të fushës të cilët nëpërmjet trajtimit të temave të ndryshme ndihmuan në rritjen e njohurive dhe ndërgjegjësimin e pjesëmarrësve mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm dhe tolerancën. Të gjitha aktivitetet janë bërë publike në faqen e web-it të Observatorit www.observator.org.al dhe fb. https://www.facebook.com/pg/observator.org.al/posts/?ref=page_internal
- Gjatë aktiviteve të debateve publike të realizuara në përgjigje të ngritjes së informimit dhe ndërgjegjësimin, nxënësit e 3 shkollave pilot krijuan 4 modele të fletëpalosjeve, 1 poster, 1 kolazh me foto dhe 3 esse që shprehin perceptimet e tyre mbi fenomenin e ekstremizmit të dhunshëm, format e shfaqjes së tij dhe çfarë duhet të bëhet për parandalim.

#FuqizimiShoqërisëCivilenëRritjeneReziliencësSëTëRinjveNdajEkstremizmitTëDhunshëm#